



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-010

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala V. K., kundër gjyqtarit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, H.S., më datë 16.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e palës V.K., kundër gjyqtarit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, H.S..

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme më datë 19 gusht 2024 është pranuar ankesa e palës V.K., e ushtruar ndaj kundër gjyqtarit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, H.S., tek Kryetari i Gjykatës Supreme si Autoritet Kompetent, konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pala ankuese, ndaj kundër gjyqtarit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, H.S., ka paraqitur ankesën e tij lidhur me aktvendimin AC-II-12-0086 i datës 22.07.2017, për caktimin e masës së përkohshme, duke shtuar tutje në pretendimet e tij se me datën 14.02.2023 ka paraqitur propozimin e tij lidhur me përfundimin e masës së përkohshme dhe anulimin e veprimeve të kryera sipas aktvendimit AC-II-12-0086, por që gjyqtari nuk ka vendosur lidhur me propozimin i cili është i natyrës urgjente.

Lidhur me pretendimet e palës, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka kërkuar nga gjyqtari H.S., të deklarohet lidhur me këtë rast dhe ka pranuar deklaratën e të njëjtit.

Në deklaratën e tij, gjyqtari S., ka deklaruar se për shkak se AKP-ja, nuk ka vepruar sipas Aktvendimit të masës së sigurimit është iniciuar kontesti tjetër për anulimin e vendimit të shitjes së Bordit të AKP-së, e që është përfunduar në shkallë të parë me aktgjykimin C-III-21-0301. Tutje, në deklaratën e tij thuhet se gjykata ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale për faktin se në lëndën në fjalë janë paraqitur disa pengesa procedurale, kjo për shkak se në vitin 2011, kishte vdekur paditësi H.M., ndërsa gjykata fare nuk ishte njoftuar për këtë rrethanë dhe deri në vitin 2024, janë kryer veprime procedurale edhe ndaj të personit të vdekur pa fajin e gjykatës, lidhur me këtë fakt jemi njoftuar nga paditësja I.M., më datë 09.02.2024.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së gjyqtarit, si dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës, vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e palës ankuese, rezulton se kemi të bëjmë vendimin në të cilin gjyqtari H.S., nuk ka qenë pjesë e vendosjes, lidhur me aktvendimin AC-II-12-0086 të datës 22.07.2017, kishte vendosur Kolegji i Apelit të Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme. Ndërsa në këtë rast, gjyqtari ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me lëndën ndaj të cilës ishte vendosur masa e sigurisë, dhe se veprimet e ndërmarra është dashur të anulohen për shkak vdekjes së paditësit, pa fajin e gjykatës kjo për shkak se gjykata ishte njoftuar me vonesë lidhur me vdekjen e paditësit H.M.. Në këtë rast veprimet e gjyqtarit në raport me lëndën janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë së tij, kjo për shkak se pengesat procedurale në lëndën konkrete kanë ardhur si pasojë e veprimeve të të tjerëve dhe jo gjyqtarit të lëndës, ky fakt vërtetohet edhe nga shkresat e lëndës, ku gjyqtari kishte pranuar njoftimin për vdekjen e paditësit më datë 09.02.2024 nga e paditura I.M., dhe se ende gjykata nuk ka pranuar provën e certifikatës së vdekjes së paditësit të ndjerë.

Në parashtrësën e palës, potencohet se kemi të bëjmë me shkelje disiplinore të sanksionuar sipas nenit 5 par.1, nënpar. 2 dhe 3, lidhur me par. 2, nënpar. 7, të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nëse marrim parasysh të gjitha shkresat e lëndës, veprimet të cilat janë ndërmarrë nga gjyqtari në rastin konkret, nuk mund të arrijmë në përfundim se gjyqtari në këtë rast në vazhdimësi nuk i ka kryer detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj. Duke marrë parasysh edhe faktin se me dispozitën e nenit 5 par. 2, të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për shkeljet nga ky paragraf kërkohet që *“Shkelje e detyrave të gjyqtarit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë”*, e që në rastin konkret nuk është vërtetuar se gjyqtari ka pasur dashje apo pakujdesi të rëndë gjatë punës së tij lidhur me trajtimin e kësaj çështje.

Pretendimet tjera të palës si në parashtrësë-ankesë, lidhur me mënyrën e vendosjes, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi, pasisa i përket vendosjes është në diskecion të gjyqtarit dhe bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thuhet se: *“Gjyqtarët gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe veprimet tjera që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre si gjyqtar”*, në rastin konkret konsideroj se veprimet e gjyqtarit në raport me lëndën konkrete nuk përbëjnë bazë për dyshim për ndonjë sjellje të mundshme disiplinore.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mënyrë shprehimore në nenin 5, ka paraparë rastet në të cilat konsiderohet se është kryer shkelje disiplinore, në rastin konkret rezulton se veprimet e gjyqtarit H.S., nuk kanë konsumuar ndonjë nga shkeljet e

parapara me këtë Ligj, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtarit H.S.,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.